



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Nr.493/21

Në bazë të nenit 118 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, nenin 10.1 dhe 10.2 dhe 14.4 të “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimin të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave”, si dhe nenin 14 paragrafi 1 pika 8 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE “INTERNATIONAL GROUP BASE” SH.P.K me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Deratizimi i podrumëve dhe garazheve publike si dhe rrjetit të kanalizimit në Komunën e Prishtinës” me numër të prokurimit: 616-21-2066-2-1-1, të iniciuar nga AK-Kuvendi i Komunës së Prishtinës, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën 02.07.2021 mori këtë :

VENDIM

- I. **Hedhet si e pa lejuar** ankesa e OE “INTERNATIONAL GROUP BASE” SH.P.K me seli në Prishtinë, me nr. të protokollit 493/21 e datës 25.06.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Deratizimi i podrumëve dhe garazheve publike si dhe rrjetit të kanalizimit në Komunën e Prishtinës” me numër të prokurimit: 616-21-2066-2-1-1, të iniciuar nga AK-Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
- II. **I LEJOHET** autoritetit kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës që të vazhdojë më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Deratizimi i podrumëve dhe garazheve publike si dhe rrjetit të kanalizimit në Komunën e Prishtinës”.

ARSYETIM

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 25.06.2021 ka pranuar ankesën me nr. 493/21 nga OE “INTERNATIONAL GROUP BASE” SH.P.K me seli në Prishtinë. Ankesa ndërlidhet me aktivitetin e prokurimit me titull: “Deratizimi i podrumeve dhe garazheve publike si dhe rrjetit të kanalizimit në Komunën e Prishtinës” me numër të prokurimit: 616-21-2066-2-1-1”, të iniciuar nga AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës kishte nxjerrë Njoftimin për Kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit me datë 15.04.2021.

Me datë 12.06.2021 OE “INTERNATIONAL GROUP BASE” SH.P.K, kishte bërë kërkesë për ri shqyrtim pranë AK-së, duke kërkuar që të vendosen kritere jodiskriminuese dhe të njëtrajtshme. Me datë 15.06.2021 AK kishte refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe kishte sqaruar se konform dispozitave të LPP-së ka bërë korrigjimet e njoftimeve duke mos ia humbur natyrën dhe fushëveprimin e aktivitetit.

OE ankues i ka pasur në dispozicion dhjetë (10) ditë pas pranimi të vendimit të AK, për të parashtruar ankesë në OSHP. Ankesën në OSHP operatori ankues e ka parashtruar më 25.06.2021, brenda afatit ligjor.

Pas pranimi të ankesës në OSHP, është vërejtur se ankesa është e pa kompletuar pasi që i mungon dëshmia e pagesës së tarifës së ankimit.

Nga data 25.06.2021 deri më 28.06.2021 OE ankues është njoftuar se duhet të kompletojë ankesën pranë OSHP-së.

Me emalin e datës 28.06.2021 OE ka sqaruar se për shkak të përditësimeve të të dhënave dhe mungesës në qasje në llogaritë bankare, nuk kanë arritur ta bëjnë pagesën e tarifës dhe të njëjtën do ta bëjnë ditën e nesërme.

Deri me datën 02.07.2021 në sistemin e të hyrave të pagesat e bëra nuk figuron se OE ankues e ka bërë pagesën.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se OE ankues ankesën me numër të protokollit 493/21

të datës 25.05.2021, e ka parashtruar në kundërshtim me nenin 10.1 (j) i “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimin të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave” cili parasheh që një ndër kriteret themelore të një ankesë është sigurimi i dëshmisë së pagesës së tarifës së ankimit, të përmendur në nenin 118 të LPP-së si në vijim:

1. Ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP vlera e së cilës do të përcaktohet nga KRPP-ja në legjislacionin dytësor. Dëshmia e pagesës duhet ti bashkëngjitet vetë ankesës në përputhje me nenin 111 të këtij ligji. Pagesa do të bëhet në para të gatshme ose në ekuivalent të parave të gatshme në një llogari të hapur nga OSHP-ja në përputhje me Rregullat Financiare.

2. OSHP nuk do të pranojë ankesën nëse tarifa nuk paguhet.

Për më tepër, neni 10.2 i “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimin të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave” specifikon se:

Nëse mungon ndonjë nga elementet e përmendura në nenin 10.1, OSHP menjëherë do ta njoftojë me shkrim parashtruesin e ankesës, në mënyrën më të shpejtë të mundur, rreth natyrës së mangësive. Nëse afati për parashtrimin e ankesës ka skaduar ose skadon për më pak se katër (4) ditë, parashtruesi i ankesës do të ketë në dispozicion katër (4) ditë pas marrjes së njoftimit të tillë për të korrigjuar të metat e tilla dhe për të ri-parashtruar ankesën. Nëse afati për parashtrimin e ankesës akoma nuk ka skaduar dhe nuk skadon për më pak se dy (2) ditë, parashtruesi i kërkesës mund të ri-parashtrtojë kërkesën në çdo kohë para skadimit të afatit për parashtrim.

Data 25.06.2021 ka qenë data e fundit për parashtrimin e ankesës pranë OSHP-së, dhe pas kërkesës për kompletim të ankesës nga OSHP, e njëjta nuk është plotësuar brenda afatit katër (4) ditor konform dispozitave ligjore si më lart.

Sipas nenit 14.4 të “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimin të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave”, ankesa do të hedhet poshtë nga OSHP nëse nuk shoqërohet me pagesë.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart OSHP konstaton se ankesa e parashtruar në OSHP nga OE “INTERNATIONAL GROUP BASE” SH.P.K me seli në Prishtinë, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi ka parashtruar ankesë në OSHP në kundërshtim me nenin 118 të LPP-së, nenin 10.1 dhe 10.2 dhe i “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimin të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave”, si dhe nenin 14 paragrafi 1 pika 8 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, duke mos paguar tarifën për ankesën e parashtruar më 25.06.2021 në OSHP, andaj e njëjta nuk hyn në shqyrtim nga OSHP.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Kuvendi i Komunës së Prishtinës

1x1 OE “INTERNATIONAL GROUP BASE” SH.P.K me seli në Prishtinë

